

VENDIM
Nr. 554, datë 22.8.2012

**PËR DHËNIE LICENCE PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT,
PARAUNIVERSITAR, SHKOLLË 9-VJEÇARE “QENDRA AKADEMIKE E LEZHËS” (LEZHA
ACADEMIC CENTER)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e licencës për hapjen, në qytetin e Lezhës, të institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë 9-vjeçare “Qendra Akademike e Lezhës”, që do të përfshijë në programin mësimor edhe lëndë në gjuhë të huaj dhe do të administrohet nga fondacioni “Albanian Mennonite Education” (Arsimi Menonit Shqiptar).

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të ndjekur zbatimin e dispozitave ligjore, nënligjore, për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha